



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

V E N D I M
Nr. 648, datë 29.12.2020

PËR

KUALIFIKIMIN E KANDIDATIT Z. {...} DHE VIJIMIN E PROCEDURAVE TË NGRITJES NË DETYRË NË GJYKATËN E LARTË, PËR DY POZICIONET E LIRA NË FUSHËN E TË DREJTËS ADMINISTRATIVE, TË SHPALLURA ME VENDIMET NR. 82 DHE NR. 83, DATË 26.02.2020, TË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

Këshilli i Lartë Gjyqësor, në mbledhjen e datës 29.12.2020, pasi u njoh me materialet e çështjes dhe Relacionin “Për gjendjen e faktit dhe ligjin e zbatueshëm në lidhje me verifikimin e pasurisë dhe të figurës, të kandidatit për në Gjykatën e Lartë, nga radhët e gjyqtarëve, z. {...}”, përgatitur nga relatorja znj. Marçela Shehu, si dhe pasi shqyrtoi propozimin për kualifikimin e kandidatit {...} dhe vijimin e procedurave të ngritjes në detyrë në Gjykatën e Lartë, për dy pozicionet e lira në fushën e të drejtës administrative, të shpallura me Vendimet nr. 82 dhe nr. 83, datë 26.02.2020 të Këshillit të Lartë Gjyqësor

V Ë R E N

I. PROCEDURA E VERIFIKIMIT

1. Me Vendimin nr. 82, datë 26.02.2020, Këshilli i Lartë Gjyqësor (më poshtë referuar si Këshilli) ka vendosur:

“1. Hapjen e procedurës së ngritjes në detyrë në Gjykatën e Lartë, nga radhët e gjyqtarëve, për një pozicion të lirë në fushën e të drejtës administrative”.

2. Në këtë vendim afati i kandidimit është përcaktuar “dy javë nga dita e publikimit i këtij vendimi në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor”.

3. Me Vendimin nr. 83, datë 26.02.2020, Këshilli ka vendosur:

“1. Hapjen e procedurës së ngritjes në detyrë në Gjykatën e Lartë, nga radhët e gjyqtarëve, për një pozicion të lirë në fushën e të drejtës administrative”.

4. Në këtë rast afati i kandidimit është përcaktuar “dy muaj nga dita e publikimit e këtij vendimi në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor”.

5. Vendimet e Këshillit si më lart janë publikuar në faqen e tij zyrtare të internetit më datë 28.02.2020, duke filluar të ecin afatet e kandidimit nga dita e nesërme, pra nga data 29.02.2020.

6. Aktualisht kanë përfunduar afatet e pezulluara¹ dhe më pas të zgjatura² të kandidimit për të dyja procedurat e ngritjes në detyrë në Gjykatën e Lartë të hapura me vendimet e sipërcituara.

7. Brenda afatit të kandidimit, për pozicionin e parë dhe të dytë të lirë në fushën e të drejtës administrative të shpallura me Vendimet nr. 82 dhe nr. 83, datë 26.02.2020, ka kandiduar edhe gjyqtari z. {...} (më poshtë referuar si kandidati), aktualisht gjyqtar pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Korçë.

8. Me Vendimin nr. 151, datë 06.05.2020, “Për fillimin e procedurës së verifikimit të kritereve ligjore të kandidimit për gjyqtar në Gjykatën e Lartë, për kandidatët nga radhët e gjyqtarëve, për pozicionet e lira të shpallura me Vendimin nr. 82, datë 26.02.2020 dhe Vendimin nr. 85, datë 26.02.2020”, Këshilli vendosi fillimin e procedurës së verifikimit të kritereve ligjore të kandidimit për kandidatët, ndër ta edhe për z. {...}, për të cilin, pas zhvillimit të shortit, caktoi si relatore znj. Marçela Shehu. Gjithashtu, me Vendimin nr. 201, datë 11.06.2020, “Për fillimin e procedurës së verifikimit të kritereve ligjore të kandidimit për gjyqtar në Gjykatën e Lartë, për kandidatët nga radhët e gjyqtarëve, për pozicionet e lira të shpallura me Vendimin nr. 83, datë 26.02.2020 dhe Vendimin nr. 86, datë 26.02.2020”, Këshilli vendosi fillimin e procedurës së verifikimit të kritereve ligjore të kandidimit për kandidatët, ndër ta edhe për z. {...}, për të cilin vendosi që procedura e verifikimit e filluar më parë³ është e vlefshme edhe për kandidimin e tij për pozicionin e lirë të shpallur me Vendimin nr. 83, datë 26.02.2020.

9. Më datë 07.05.2020, në respektim të detyrimeve të përcaktuara në Seksionin A, Kreu VI, të Vendimit 75/2019, në rrugë elektronike, kandidati u njoftua:

- për fillimin e procedurës së verifikimit të kushteve dhe kritereve ligjore të kandidimit;
- për caktimin e relatorit të kësaj procedure verifikimi;
- për të drejtën që kishte për të kërkuar përjashtimin e relatorit të caktuar dhe/ose të çdo anëtar tjetër të Këshillit, brenda 3 (tre) ditëve nga marrja e këtij njoftimi.

10. Brenda afatit të përcaktuar kandidati nuk parashtroi ndonjë pretendim në lidhje me relatorin e caktuar për procedurën e verifikimit ndaj tij apo për ndonjë anëtar tjetër të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

11. Më datë 12.05.2020, bazuar në pikën 8, Seksioni B, Kreu VI, të Vendimit 75/2019, në rrugë elektronike, kandidatit iu dërguan formularët dhe autorizimet përkatëse (të përcaktuara në pikën 6, Seksioni B, Kreu VI, të Vendimit 75/2019) që duhet të plotësoheshin dhe dorëzoheshin prej tij në kuadër të procedurës së verifikimit të kushteve dhe kritereve ligjore të kandidimit.

12. Brenda afatit pesëditor, kandidati depozitoi rregullisht dokumentacionin e kërkuar të kandidimit, pranë Zyrës së Protokollit të Këshillit të Lartë Gjyqësor, ndërsa brenda afatit 21 ditor (sipas pikës 4, Seksioni A, Kreu IX, të Vendimit 75/2019), ai dorëzoi rregullisht edhe formularin “Deklaratë e pasurisë dhe interesave privatë të kandidatit për pozicione të ndryshme në institucionet e sistemit të drejtësisë” pranë Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (më poshtë referuar si ILDKPKI).

¹ Më datë 12.03.2020.

² Me vendimin nr. 142, datë 22.04.2020.

³ Me Vendimin nr. 151, datë 06.05.2020.

13. Në vijim të procedurës së verifikimit, më datë 19.05.2020, bazuar në pikën 10, Seksioni B, Kreu VI, të Vendimit 75/2019, përmes shkresave të veçanta, u kërkua informacion dhe raportim nga institucionet kompetente për verifikimin e pasurisë dhe të figurës, për kandidatët e Gjykatës së Lartë, ndër ta edhe për kandidatin z. {...}.

14. Në pikën 9, të Vendimeve të Këshillit nr. 82 dhe nr. 83, datë 26.02.2020, është përcaktuar se: *“Për kandidatin, për të cilin me vendim të Këshillit të Lartë Gjyqësor verifikohet plotësimi i kriterëve ligjore të kandidimit sipas shkronjave “a”⁴, “c”⁵ dhe “ç”⁶, të pikës 5, të këtij vendimi, fillon menjëherë procesi i vlerësimit etik dhe profesional: ...”*. Në respektim të vendimeve si më lart të Këshillit, sa i përket plotësimit të tre kriterëve formale të kandidimit për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Lartë, që janë kriteri i *“përvojës profesionale minimale”*, i *“mospasjes masë disiplinore në fuqi”* dhe i *“mosqenies në situatën e papajtueshmërisë ambientale*, me qëllim realizimin paralelisht edhe të procedurave të vlerësimit etik dhe profesional të kandidatëve, pra në funksion të përmbylljes sa më parë të procedurave të kandidimit, për kandidatin z. {...} u kërkua dhe u administrua informacioni i nevojshëm nga institucionet kompetente.

15. Në përfundim të procedurës së verifikimit paraprak për kandidatin z. {...} në lidhje me tre kriteret formale të kandidimit të tij për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Lartë, për dy pozicionet e lira të përmendura më lart në fushën e të drejtës administrative, Këshilli me Vendimin nr. 211, datë 18.06.2020, ka vendosur:

“1. Verifikimin e plotësimit nga kandidati z. {...}, në procedurat e ngritjes në detyrë në Gjykatën e Lartë, për dy pozicionet e lira në fushën e të drejtës administrative, të shpallura me Vendimet e Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 82 dhe nr. 83, datë 26.02.2020, të kriterëve të “përvojës profesionale minimale”, të “mospasjes masë disiplinore në fuqi” dhe të “mosqenies në situatën e papajtueshmërisë ambientale”.

2. Vijimin e procedurës së verifikimit të kandidatit për kriteret e tjera ligjore të kandidimit në procedurat e ngritjes në detyrë në Gjykatën e Lartë, për dy pozicionet e lira në fushën e të drejtës administrative, të shpallura me Vendimet e Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 82 dhe nr. 83, datë 26.02.2020....”.

16. Ndërkohë, në lidhje me kriteret e verifikimit të pasurisë dhe të figurës, pas kërkesave konkrete, Institucionet kompetente kanë përcjellë për Këshillin e Lartë Gjyqësor informacionet dhe raportimet e tyre në kohë të ndryshme (siç do të përshkruhet më poshtë).

17. Pas administrimit të dokumentacionit të nevojshëm, duke çmuar se procedura e verifikimit të pasurisë dhe të figurës për kandidatin {...} për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Lartë, për

⁴ Në pikën 5, shkronja “a”, të Vendimeve të Këshillit nr.82 dhe nr. 83, datë 26.02.2020, përcaktohet se: *“Kriteret ligjore që duhet të plotësojë kandidati për t’u ngritur në detyrë në Gjykatën e Lartë përcaktohen ..., si mëposhtë: a) Kandidati duhet të ketë ushtruar ushtruar funksionin jo më pak se trembëdhjetë vjet në nivele më të ulëta, nga të cilat të paktën pesë vjet në fushën e së drejtës administrative, duke përfshirë edhe përvojën si magjistrat i komanduar”.*

⁵ Në shkronjën “c” të pikës 5, të këtyre dy vendimeve, përcaktohet se: *“c) Kandidati duhet të mos ketë masë disiplinore në fuqi;*

⁶ Në shkronjën “ç” të pikës 5, të këtyre dy vendimeve, përcaktohet se: *ç) Kandidati duhet të mos jetë në situatën e papajtueshmërisë ambientale sipas përcaktimeve të pikës 3, të nenit 8, të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar”.*

pozicionet e lira në fushën e të drejtës administrative, të shpallura me Vendimet e Këshillit nr. 82 dhe nr. 83, datë 26.02.2020, ishte e plotë dhe në përputhje me kërkesat e Vendimit 75/2019, relatorja e çështjes e parashitroi çështjen përpara Komisionit të Zhvillimit të Karrierës.

18. Komisioni i Zhvillimit të Karrierës e shqyrtoi çështjen në mbledhje më datë 06.07.2020 dhe, pasi vlerësoi të plotë procedurën e verifikimit në këtë rast, në bazë të Vendimit 75/2019, vendosi kalimin e saj për shqyrtim në mbledhjen e Këshillit të Lartë Gjyqësor për të vlerësuar dhe vendosur ky i fundit për kualifikimin e kandidatit {...} dhe vijimin e procedurës së mëtejshme të emërimit në Gjykatën e Lartë për dy pozicionet e lira në fushën e të drejtës administrative, të shpallura me Vendimet e Këshillit nr. 82 dhe nr. 83, datë 26.02.2020 ose skualifikimin e kandidatit dhe përjashtimin e tij nga procedura e emërimit në këto pozicione në Gjykatën e Lartë.

19. Më datë 09.09.2020, bazuar në nenin 146, të Kodit Zgjedhor të Republikës së Shqipërisë, i ndryshuar me Ligjin nr. 101/2020 (miratuar më datë 23.07.2020, botuar në Fletoren Zyrtare nr. 143, datë 4 Gusht 2020 dhe hyrë në fuqi më datë 19.08.2020), z. {...} u përzgjodh me short si anëtar i Kolegjit Zgjedhor. Zgjedhja e tij në këtë detyrë u miratua me Vendimin nr. 293, datë 09.09.2020, të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Si rezultat i kësaj, ndërsa sipas shkronjës “b”, pika 1, të nenit 149, të këtij Kodi përcaktohej se *“Gjyqtari gjatë ushtrimit të detyrës në Kolegjin Zgjedhor Gjyqësor nuk mund: ...; b) të lëvizet nga detyra në mënyrë të përkohshme apo të përhershme për shkaqe ... apo ngritje në detyrë”*, procedura e verifikimit nuk vijoi në pritje të shqyrtimit nga Kuvendi i Shqipërisë të nismës ligjore, ndër të tjera, edhe për ndryshimin e kësaj dispozite. Me Ligjin nr.118/2020, u shfuqizua togfjalëshi *“apo ngritje në detyrë”*, në shkronjën “b”, pika 1, të nenit 149, të Kodit Zgjedhor. Ky ligj u botua në Fletoren Zyrtare nr. 191, datë 3 nëntor 2020, duke hyrë ai në fuqi më datë 18.11.2020.

20. Për rrjedhojë, me rënien e pengesës ligjore më datë 18.11.2020, shqyrtimi i rezultateve të verifikimit të pasurisë dhe të figurës për kandidatin {...} për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Lartë u përfshi në Mbledhjen Plenare të Këshillit të Lartë Gjyqësor të datës 29.12.2020.

II. REZULTATET E VERIFIKIMIT TË PASURISË DHE TË FIGURËS

21. Neni 48, pika 7 dhe pika 8, të Ligjit nr. 96/2016 *“Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”*, i ndryshuar (më poshtë referuar si Ligji për Statusin), përcakton se: *“7. Këshilli verifikon kandidatët, sipas parashikimeve të pikave 2 deri në 7, të nenit 32, të këtij ligji. 8. Vetëm kandidatët të cilët kalojnë verifikimin e pasurisë dhe figurës ..., pranohen në procedurat e mëtejshme të ngritjes në detyrë”*.

22. Ky përcaktim ligjor në lidhje me verifikimin e pasurisë dhe figurës së kandidatëve për ngritjen në detyrë, ndër të tjera edhe në Gjykatën e Lartë, është rregulluar më tej në aktin nënligjor të Këshillit, në Vendimin nr. 75, datë 23.05.2019, *“Për procedurën e verifikimit të kushteve dhe kritereve ligjore për rekrutimin e kandidatëve për gjyqtarë, për zhvillimin e karrierës së gjyqtarëve dhe për emërimin e gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë”* (në vijim referuar si Vendimi 75/2019).

Pasur parasysh faktin se të gjithë gjyqtarët në detyrë, bazuar në nenin 179 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe në Ligjin 84/2016 *“Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”*, janë subjekt rivlerësimi kalimtar *“ex officio”*, rivlerësim ky që përfshin edhe verifikimin e pasurisë dhe figurës, Këshilli parashikoi rregulla specifike për

gjqtarët subjekt rivlerësimi kalimtar që kandidonin për ngritjen në detyrë, sa i përkiste verifikimit të pasurisë dhe figurës së tyre.

23. Konkretisht, në Seksionin B, Kreu X, të Vendimit 75/2019, titulluar “Verifikimi i pasurisë dhe figurës së kandidatëve subjekt i procedurës së rivlerësimit kalimtar sipas ligjit nr. 84/2016”, përcaktohet se: *“1. Kandidatët që i janë nënshtruar procedurës së rivlerësimit kalimtar sipas Ligjit nr. 84/2016 dhe janë konfirmuar në detyrë nga organet e rivlerësimit kalimtar, me vendim të formës së prerë, nuk i nënshtrohen procedurës së verifikimit të pasurisë dhe të figurës sipas përcaktimeve të pikave 2 deri në 7, të nenit 32, të Ligjit për Statusin. ... 3. Pavarësisht nga parashikimet e pikave 1 dhe 2 të këtij Seksioni, kandidatët subjekt i procedurës së rivlerësimit kalimtar sipas Ligjit nr. 84/2016, do t’i nënshtrohen menjëherë procedurave të verifikimit të integritetit sipas Ligjit nr. 45/2015 “Për të drejtën e informimit për dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë”. 4. Procedura e përcaktuar në pikat 2 deri në 7, të nenit 32, të Ligjit për Statusin, për verifikimin e integritetit të kandidatëve subjekt i procedurës së rivlerësimit kalimtar sipas Ligjit nr. 84/2016, për kandidatët që i janë nënshtruar procedurës së rivlerësimit kalimtar sipas Ligjit nr. 84/2016 dhe janë konfirmuar në detyrë nga organet e rivlerësimit kalimtar, shtrihet për periudhën pas asaj të datës që ka marrë formë të prerë vendimi i dhënë nga organet e rivlerësimit kalimtar. ... 6. Nëse procedurat e verifikimit të kushteve dhe kriterëve të tjera ligjore të kandidatëve subjekt i procedurës së rivlerësimit kalimtar sipas Ligjit nr. 84/2016, fillojnë pas afatit 180 ditor të përcaktuar nga pika 2 e nenit 3/1 të Ligjit nr. 9049/2003, procedura e verifikimit të pasurisë së këtyre kandidatëve shtrihet mbi interesat pasurore, private dhe konfliktin e interesit, për periudhën pas asaj të datës që ka marrë formë të prerë vendimi i dhënë nga organet e rivlerësimit kalimtar për konfirmimin e tyre në detyrë. 7. Kandidatët subjekt i procedurës së rivlerësimit kalimtar sipas Ligjit nr. 84/2016, të cilët nuk janë konfirmuar në detyrë me vendim të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, edhe kur ndaj atij vendimi është paraqitur ankim, nuk pranohen të kandidojnë dhe nuk i nënshtrohen procedurës së verifikimit të kushteve dhe kriterëve të tjera ligjore të kandidimit sipas pikave 2 deri në 7, të nenit 32, të Ligjit për Statusin”.*

24. Sa sipër, kandidati për gjyqtar në Gjykatën e Lartë nga radhët e gjyqtarëve, për t’u kualifikuar për ngritjen në detyrë, do të duhet në çdo rast të kalojë me sukses verifikimin e pasurisë dhe të figurës. Megjithatë, në rastin e kandidatit që i është nënshtruar dhe ka kaluar me sukses procesin e rivlerësimit kalimtar sipas Ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, verifikimi për të i pasurisë dhe figurës sipas pikave 2 deri në 7, të nenit 32, të Ligjit për Statusin, do të shtrihet për periudhën pas datës që ka marrë formë të prerë vendimi i dhënë nga organet e rivlerësimit kalimtar. Në kuadër të verifikimit të figurës, ky kandidat i nënshtrohet verifikimit të integritetit sipas Ligjit nr. 45/2015 “Për të drejtën e informimit për dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë.

25. Rezulton se kandidati, z.{...} i është nënshtruar procesit të rivlerësimit kalimtar, ndërsa është konfirmuar në detyrë me vendim përfundimtar, pikërisht me Vendimin nr. 193, datë 06.09.2019, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit. Për rrjedhojë, verifikimi i pasurisë dhe figurës për këtë kandidat u shtri për periudhën pas datës 02.12.2019, që ka marrë formë të prerë vendimi i organeve të rivlerësimit kalimtar për konfirmimin e tij në detyrë.

A. Për kriterin e pasurisë

26. Për kandidatin {...} u verifikua kriteri i pasurisë, përcaktuar në pikat 7 dhe 8, të nenit 48 në lidhje me pikat 2 deri në 7, të nenit 32⁷, të Ligjit për Statusit, për periudhën pas dhënies së vendimit nga organet e rivlerësimit kalimtar.

27. Konkretisht, për verifikimin e kriterit të pasurisë për kandidatin {...}, u kërkua raportim nga Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurisë dhe Konfliktit të Interesave (më poshtë referuar si ILDKPKI), i cili ka dërguar në Këshillin e Lartë Gjyqësor Raportin nr. 169/24 prot., datë 25.06.2020.

27.1 Sipas këtij Raporti të ILDKPKI-së, kandidati {...} ka plotësuar dhe depozituar në afatin e caktuar nga Këshilli i Lartë Gjyqësor formularin e deklaratës së pasurisë, si dhe autorizimet e kërkuara për verifikimin e pasurisë.

27.2 Po ashtu, sipas këtij Raporti të ILDKPKI-së, nga kjo e fundit janë kryer kontrole të plota për pasuritë, asetet dhe interesat e deklaruara nga kandidati {...}, për periudhën pas dhënies së vendimit nga ana e organeve të rivlerësimit, duke konkluduar se për kandidatin:

- a) deklarimi është i saktë në përputhje me ligjin;
- b) ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasurinë;
- c) nuk ka kryer fshehje të pasurisë;
- d) nuk ka kryer deklarim të rremë;
- e) subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.

28. Për verifikimin e kriterit të pasurisë për kandidatin {...} u kërkua informacion Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave.

⁷ “2. ..., për secilin kandidat ..., Këshillat kërkojnë raportim nga institucionet kompetente për verifikimin e pasurisë dhe të figurës në lidhje me çdo shkak tjetër përjashtues, nga Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave, prokuroria, organet e administratës tatimore dhe doganore, Byroja Kombëtare e Hetimit, shërbimet shtetërore informative, si dhe çdo organ disiplinor që ka mbikëqyrur disiplinën në marrëdhëniet e punës së kandidatit. Nëse është e nevojshme, Këshillat kërkojnë informacion shtesë nga institucionet e përmendura në këtë pikë. 3. Çdo institucion publik, subjekt fizik ose juridik, duhet të përmbushë kërkesat e Këshillave për informacion, dokumentacion, ose materiale të tjera në lidhje me një hetim, me përjashtim të rasteve të kufizuara me ligj, brenda afatit ligjor të arsyeshëm të përcaktuar nga Këshillat në kërkesën e tyre. 4. Në çdo rast, kandidati nuk pranohet ... kur: a) raporti i Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe të Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave tregon që burimet financiare të kandidatit nuk justifikojnë pasuritë e tij dhe nuk ka deklaruar pasuri ose aset ose ka dhënë një deklaratë të rreme ose jo të saktë të aseteve; b) raportet e Byrosë Kombëtare të Hetimit ose Shërbimit Informativ Shtetëror tregojnë se kandidati ka lidhje me krimin e organizuar, sipas përcaktimeve të bëra në ligjin "Për organizimin dhe funksionimin e institucioneve për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar"; c) ka ndonjë shkak tjetër përjashtues të njohur, të parashikuar sipas ligjit. 5. ..., Këshillat vendosin pranueshmërinë e kandidatëve, bazuar në informacionin që kanë marrë për rezultatet e verifikimit të pasurisë dhe figurës së tyre. ...”.

28.1 Nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve informacioni u dërgua me Shkresën nr. 8498/1 prot., datë 03.06.2020, protokolluar në Këshill me aktin nr. 2331/1 prot., datë 05.06.2020, ku për kandidatin {...} rezulton të mos jetë i regjistruar për ushtrimin e ndonjë aktiviteti privat.

28.2 Nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave informacioni u dërgua me Shkresën nr. 9228/1 prot., datë 28.05.2020, protokolluar në Këshill me aktin nr. 2332/1 prot., datë 01.06.2020, ku për kandidatin {...} nuk jepet ndonjë e dhënë me karakter pasuror.

29. Në kushtet kur nga informacionet respektive të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave nuk jepej ndonjë e dhënë me karakter pasuror për kandidatin, u vlerësua se nuk kishte vend për t'iu kërkuar ILDKPKI-së bërja e një kontrolli shtesë.

30. Po ashtu, referuar të të dhënave të përshkruara në Raportin e ILDKPKI-së, të nxjerra nga dokumentacioni i paraqitur nga vetë kandidati, si dhe ai i administruar nga korrespondenca me subjekte shtetërorë dhe privatë, dokumentacion që evidentohet hollësisht në Raport, sikundër dhe analizës financiare të bërë nga ky organ publik, përgjegjës për kontrollin e deklarimit të pasurive dhe konfliktit të interesave sipas Ligjit nr. 9049, datë 10.04.2003, "Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publik", i ndryshuar, nuk u konstatua paplotshmëri ose mangësi në raportim, shkak për të cilin u vlerësua se nuk kishte vend për raportim shtesë nga ky organ.

31. Nga verifikimi i kriterit të pasurisë për kandidatin {...} janë grumbulluar të dhëna të mjaftueshme mbi të cilat mund të konkludohet se për të nuk ekziston asnjë prej shkaqeve të skualifikimit nga kandidimi dhe refuzimin e emërimit të tij si gjyqtar në Gjykatën e Lartë sa i përket kriterit të pasurisë. Konkretisht verifikohet që:

- a) kandidati ka plotësuar dhe depozituar rregullisht formularin e deklaratës së pasurisë;
- b) kandidati ka plotësuar dhe depozituar rregullisht, të nënshkruara, autorizimet e kërkuara për verifikimin e pasurisë;
- c) kandidati ka burime financiare për të justifikuar pasuritë e tij;
- ç) deklarimi nga kandidati i pasurisë, aseteve ose të interesave private, të detyrueshme për t'u deklaruar, është i plotë, i vërtetë dhe i saktë.

B. Për kriterin e figurës

32. Për kandidatin {...} u verifikua kriteri i figurës, përcaktuar në pikat 7 dhe 8, të nenit 48 në lidhje me pikat 2 deri në 7, të nenit 32, të Ligjit për Statusit, për periudhën pas dhënies së vendimit nga organet e rivlerësimit.

33. Konkretisht, për verifikimin e kriterit të figurës për kandidatin {...}, u kërkuar raportim nga institucionet ligjzbatuese të përcaktuara në pikën 2, të nenit 32, të Ligjit për Statusit, me përjashtim të Byrosë Kombëtare të Hetimit, e cila nuk ka filluar ende ushtrimin e funksioneve të saj pasi

vetëm së fundmi Këshilli i Lartë i Prokurorisë ka emëruar Drejtorin e Byrosë Kombëtare të Hetimit⁸, ndërsa më datë 08.09.2020, janë hapur aplikimet për hetues të këtij institucioni⁹.

34. Nga raportimet e institucioneve ligjzbatuese nuk u identifikua dhe verifikua ndonjë e dhënë për lidhje ose kontakte të papërshtatshme të kandidatit {...} me persona të përfshirë në krimin e organizuar apo për përfshirjen e tij në veprimtari që cenojnë sigurinë kombëtare apo aktivite të kundërligjshme.

35. Po ashtu, për verifikimin e kriterit të figurës për kandidatin {...}, në kushtet kur ky kandidat ka qenë magjistrat në detyrë në momentin e hyrjes në fuqi të Ligjit nr. 138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, i ndryshuar, në përputhje me detyrimet e përcaktuara nga ky ligj, kandidati i është nënshtruar verifikimit sipas këtij ligji. Për rrjedhojë, informacioni iu kërkua Strukturës së Posaçme për regjistrimin, administrimin dhe përpunimin e formularëve të vetëdeklarimit në zbatim të ligjit nr. 138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike” pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.

36. Nga Struktura e Posaçme pranë Këshillit informacioni u dërgua me Shkresën nr. 2334/1 prot., datë 27.05.2020, ku për kandidatin {...} është bërë me dije se:

- ka dorëzuar formularin e vetëdeklarimit më datë 24.06.2016;
- formulari i vetëdeklarimit është bërë publik, në faqen zyrtare të web;
- në formularin e vetëdeklarimit, nuk ka të deklaruar të dhëna që përfshihen brenda sferës së ndalimeve të parashikuara nga ligji;
- nga përgjigjet e ardhura nga zyra e gjendjes gjyqësore dhe zyra e gjendjes civile, nuk ka rezultuar ndryshime të të dhënave të gjendjes civile apo gjendjes gjyqësore, nga ato të deklaruara;
- deri më sot nuk ka patur indicie apo të dhëna kryesisht, për të kërkuar verifikim të thelluar nga Prokuroria e Përgjithshme.

37. Kandidati z.{...} nuk iu nënshtrua verifikimit të integritetit sipas Ligjit nr. 45/2015 “Për të drejtën e informimit për dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë, në kushtet kur ai nuk është i vitlindjes më të hershme se Korrik 1977 (kandidati është i vitlindjes 1979), sikurse përcaktohet në pikën 8, Seksioni B, Kreu IX, të vendimit 75/2019.

38. Nga verifikimi i kriterit të figurës për kandidatin {...} janë grumbulluar të dhëna të mjaftueshme mbi të cilat mund të konkludohet se për të nuk ekziston asnjë prej shkaqeve të skualifikimit nga kandidimi dhe refuzimin e emërimit të tij si gjyqtar sa i përket kriterit të figurës. Konkretisht verifikohet që:

- a) kandidati ka plotësuar dhe depozituar rregullisht formularin e vetëdeklarimit sipas kërkesave të Ligjit nr. 138/2015;
- b) kandidati ka plotësuar dhe depozituar rregullisht, të nënshkruara, autorizimin për Këshillin e Lartë Gjyqësor që, në zbatim të pikës 2 të nenit 32 të Ligjit të Statusit, të kryejë

⁸ Vendimi nr. 183, datë 30.07.2020.

⁹ Sipas njoftimit në faqen zyrtare: <https://bkh.al/2020/09/08/njoftim-per-shpalljen-e-konkursit-per-pozicionet-hetues-ne-byrone-kombetare-te-hetimit/>

- verifikimin në organet kompetente sipas ligjit, për të dhënat që lidhen me figurën dhe integritetin e tij;
- c) për kandidatin nuk ka të dhëna për lidhje ose kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar;
 - ç) për kandidatin nuk ka të dhëna që të ketë qenë anëtar, bashkëpunëtor ose i favorizuar nga Sigurimi i Shtetit, përpara datës 2 korrik 1991, në kuptimin e Ligjit nr. 45/2015 “Për të drejtën e informimit për dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë”, i ndryshuar;
 - d) për kandidatin nuk ka të dhëna që të ketë qenë ose të jetë bashkëpunëtor, informator ose agjent i shërbimeve të inteligjencës;
 - dh) për kandidatin nuk ka ndonjë të dhënë tjetër në lidhje me figurën dhe integritetin e tij mbi të cilën të ngrihen dyshime për pranueshmërinë ose jo të tij për emërimin si gjyqtar në Gjykatën e Lartë.

III. KONKLUZIONE

39. Referuar përcaktimeve të Vendimit 75/2019, nga shqyrtimi i dokumentacionit të administruar gjatë procedurës së verifikimit të kushteve dhe kriterëve ligjore të kandidimit për gjyqtar në Gjykatën e Lartë për kandidatin z. {...}, Këshilli i Lartë Gjyqësor vlerëson se procedura e verifikimit e ndjekur në këtë rast është e plotë dhe në përputhje me ligjin.

40. Bazuar në sa më lart është parashtruar mbi rezultatet e verifikimit të kushteve dhe kriterëve ligjore të kandidimit për gjyqtar në Gjykatën e Lartë për kandidatin z. {...}, Këshilli i Lartë Gjyqësor vlerëson se kandidati i përmbush ato, ndërsa nuk ekziston ndonjë shkak për skualifikimin dhe refuzimin e emërimit të tij. Nisur nga kjo, Këshilli çmon se është vendi për kualifikimin e kandidatit dhe vijimin e procedurave të ngritjes në detyrë në Gjykatën e Lartë, për dy pozicionet e lira në fushën e të drejtës administrative, të shpallura me Vendimet e Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 82 dhe nr. 83, datë 26.02.2020

PËR KËTO ARSYE

Mbështetur në pikën 3, të nenit 136, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në nenin 8, në pikën 5, të nenit 47, në pikat 7 dhe 8, të nenit 48, të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, si dhe në shkronjën “dh”, pika 12, Seksioni Ç, Kreu VI, të Vendimit të tij nr. 75, datë 23.05.2019 “Për procedurën e verifikimit të kushteve dhe kriterëve ligjore për rekrutimin e kandidatëve për gjyqtarë, për zhvillimin e karrierës së gjyqtarëve dhe për emërimin e gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë”, Këshilli i Lartë Gjyqësor,

V E N D O S I :

1. Kualifikimin e kandidatit z. {...} dhe vijimin e procedurave të ngritjes në detyrë në Gjykatën e Lartë, për dy pozicionet e lira në fushën e të drejtës administrative, të shpallura me Vendimet e Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 82 dhe nr. 83, datë 26.02.2020.
2. Vendimi nr. 211, datë 18.06.2020, i Këshillit të Lartë Gjyqësor është pjesë përbërëse e këtij vendimi.

3. Një kopje e arsyetuar e vendimit i njoftohet kandidatit z. {...} sipas kërkesave të nenit 98 të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar.

Ky vendim hyn në fuqi në datën e publikimit në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR